


Auditues të KLSH-së ndjekin webinarin e IDI-t mbi auditimin e zbatimit të SDG-ve

Më datë 26 nëntor 2024, auditues të KLSH-së ndoqën në formatin online webinarin e organizuar nga IDI mbi auditimin e zbatimit të SDG-ve.

Sesioni i Parë: ISAM dhe konteksti i tij

ISAM 2024 ofron udhëzime praktike për SAI-t për të audituar zbatimin e SDG-ve. Ai përfshin gjithashtu konsiderata për planifikimin strategjik për ndikim duke përfshirë auditime të



zbatimit të SDG-ve në planet strategjike dhe vjetore të auditit të SAI-ve. Ndërsa fokusohet në koherencën e politikave dhe qasjen e qeverisë si një tërësi, ISAM njih diversitetin e SAI-ve dhe ofron udhëzime për realizimin e auditimeve që përputhen me ISSAI-t, kontribuojnë në ndikimin e auditimit të SAI-ve, si dhe

vendosin theksin në parimin "mos të mbetet askush pas".

Çfarë është e re në modelin e auditimit të SDG-ve të IDI-t? Më shumë metodologji, mjete, shembuj praktikë, duke u fokusuar në zbatimin e SDG-ve në mënyrë më të gjerë dhe më praktike.

ISAM 2024 përmban një definicion të rishikuar të auditimit të zbatimit të SDG-ve dhe identifikon dy pika kryesore hyrëse – proceset dhe programet, për të realizuar auditime mbi zbatimin e SDG-ve.

- Auditimi i proceseve do të përqendrohet në proceset për të zbatuar SDG-të në nivelin kombëtar nëpër sektorët dhe nivelet e qeverisë;
- Auditimi i programeve fokusohet në auditimin e zbatimit të një seti programesh që kontribuojnë në arritjen e objektivave të zgjedhura të lidhura me një ose më shumë objektiva globale të SDG-ve;

Në përfundim, këto auditime duhet të lejojnë audituesin të konkludojë për përpjekjet e qeverisë në realizimin e parimit për të mos lënë askënd pas dhe angazhimin e përfshirjes së palëve të interesuara.

Kur zhvillohet plani strategjik dhe vjetor i auditimit, duhet të merret parasysh zbatimi i SDG-ve dhe të shqyrtohen katër fusha:

- Si do të kontribuojë rezultati i auditimit në qëllimin e SAI-ve për zbatimin e SDG-ve;
- Çfarë lloji portofoli auditimesh dëshironi dhe çfarë çështjesh doni të adresoni;

- A ka kapacitet dhe burime SAI për të realizuar këtë auditim;
- Monitorimi, vlerësimi, mësimi;

Sesioni i Dytë: Si të shqyrtojmë koherencën e politikave ndërsa auditojmë zbatimin e SDG-ve?

Koherenca e politikave është një element thelbësor i përkufizimit të auditimit të zbatimit të SDG-ve. Duke shqyrtuar koherencën e politikave në auditimet e tyre të zbatimit të SDG-ve, Institucionet Supreme të Auditimit (SAI-t) kontribuojnë në transparencën, efektivitetin dhe efikasitetin e administratës publike dhe në zbatimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG-ve).

Kuadri i Auditimit të Koherencës së Politikave është një udhëzues praktik i krijuar për të ndihmuar audituesit të kuptojnë dhe vlerësojnë koherencën e politikave në auditimet e zbatimit të SDG-ve. Ai fokusohet në dy pika hyrëse kryesore të identifikuara në ISAM: proceset dhe programet. Proceset mund të jenë horizontale, nëpër sektorë, dhe vertikale, nëpër nivelet e qeverisë, ndërsa programet mund të jenë horizontale, nëpër sektorë ose brenda kufijve të një sektori, dhe vertikale, nëpër nivelet e qeverisë dhe brenda një ose më shumë sektorëve.

Ka katër dimensionet e koherencës së politikës, si më poshtë:

- Horizontale: si një politikë përputhet me qëllimet e vendeve;
- Horizontale/ndër-sektoriale: si një politikë përputhet me qëllimet afatgjata të vendeve;
- Vertikale: si një politikë kombëtare përputhet me politikën lokale;
- Ndër-juridiksionale: koherenca midis politikave të vendeve të zhvilluara me ato të vendeve në zhvillim;

SAI-t mund të luajnë një rol në koherencën e politikave përmes vlerësimit të ndryshimeve në performancën e mekanizmave institucionalë në lidhje me koherencën e rezultateve që ata ofrojnë.

Sesioni i Tretë: Si të shqyrtojmë përpjekjet e qeverisë për të zbatuar parimin LNOB (mos të mbetet askush pas)?

Parimi i “Mos të mbetet askush pas” (LNOB) është shumë i rëndësishëm për Axhendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG). Ai synon të sigurojë rezultate gjithëpërfshirëse dhe të barabarta për të gjithë, jo vetëm për grupet që tashmë shërbehen mirë në shoqëri.

LNOB përpiket të adresojë pabarazitë në mundësi dhe akses të politikave dhe burimeve publike, duke siguruar që fondet publike, të cilat janë të kufizuara menaxhohen për të promovuar më shumë barazi.

Pikat hyrëse për auditimin e LNOB janë:

- Proceset: duke e parë LNOB si një proces në qendër të qeverisë për zbatimin e SDG-ve në nivel kombëtar;
- Programet: që kontribuojnë në arritjen e treguesve të SDG-ve që lidhen drejtpërdrejt me LNOB;

Ka disa sfida për të audituar LNOB, të tilla si:

- mungesa e të dhënave të ndara,
- arritja deri tek grupet e ndjeshme për t'i përfshirë ato në procesin e auditimit;
- aftësia e audituesve për të ndër-vepruar me grupet e ndjeshme;
- ruajtja e objektivitetit;
- kostot dhe burimet për të zbatuar rekomandimet e auditimit;
- qasja e audituesit ndaj LNOB-it dhe gjithëpërfshirjes;